VENDIM
Nr.852, datë 21.10.2010

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË FALIMENTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 282/2 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Organizimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit

1. Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentimit, në vijim Agjencia, është person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

2. Agjencia drejtohet nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.

3. Struktura dhe organika e Agjencisë përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Paga e drejtorit dhe e punonjësve të Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Agjencia financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga të ardhurat nga tarifat e realizuara nga veprimtaria e saj.

5. Procedura e rekrutimit të nëpunësve të Agjencisë kryhen në përputhje me përcaktimet për këto procedura në legjislacionin e shërbimit civil.

6. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj administrative në përputhje me aktet nënligjore, të miratuara nga Ministri i Drejtësisë, në bazë dhe në zbatim të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", të ndryshuar.

II. Funksionimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit

7. Agjencia është organi kompetent shtetëror për mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratorëve të falimentimit dhe për kontrollin e zbatimit të legjislacionit të falimentimit.

8. Drejtori i Agjencisë, përveç kërkesave të tjera në përputhje me dispozitat që rregullojnë emërimin e drejtuesve të institucioneve qendrore, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) Të ketë përfunduar program studimi të ciklit të dytë të arsimit të lartë, në degët ekonomi apo drejtësi;

b) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion;

c) Të mos ketë masa disiplinore të largimit nga administrata publike për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil për paaftësi në kryerjen e detyrave;

ç) Të ketë titull ose gradë shkencore në administrim biznesi, menaxhim publik apo në të drejtën tregtare.

9. Drejtori i Agjencisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

a) drejton veprimtarinë e përditshme të Agjencisë;

b) përfaqëson Agjencinë në marrëdhëniet me të tretët;

c) harton projektbuxhetin vjetor të Agjencisë;

ç) propozon standardet kombëtare për administrimin e masës së falimentimit, si dhe Kodin e Etikës;

d) I propozon për miratim Ministrit të Drejtësisë rregulloren e brendshme organizative të Agjencisë dhe çdo akt tjetër normativ, që i shërben veprimtarisë administrative të kësaj Agjencie;

dh) I raporton çdo vit, ose edhe kur i kërkohet, Ministrit të Drejtësisë për veprimtarinë e

Agjencisë;

e) Emëron dhe shkarkon punonjësit e Agjencisë;

ë) Autorizon me shkrim njërin nga punonjësit e Agjencisë për ta zëvendësuar për problemet administrative, në rast të mungesës së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) Miraton kërkesat e posaçme të vendeve të punës për rekrutimin e punonjësve të Agjencisë;

g) Lidh kontrata me persona, fizikë e juridikë, vendas e të huaj, në rast se kërkohet ekspertizë e veçantë në ushtrimin e detyrave.

10. Agjencia mban dhe përditëson regjistrin, në formë shkresore dhe elektronike, të administratorëve të certifikuar të falimentimit. Formati dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Agjencisë.

11. Agjencia ka të drejtë të mbikëqyrë dhe të kontrollojë periodikisht, në çdo kohë, subjektet e certifikuara prej saj, si dhe të kërkojë e të verifikojë çdo informacion, të cilin e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të ngarkuara me ligj. Rregulla më të hollësishme për procedurat e mbikëqyrjes dhe të kontrollit miratohen nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Agjencisë.

12. Agjencia, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, organizon dhe zhvillon provimin për administratorët e falimentimit. Rregulla më të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2011, për Ministrinë e Drejtësisë.

14. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha